

NJOFTIM

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR FONDIN E EKSELENCËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019–2020.

Dokumentacioni i aplikimit, kriteret dhe procedurat mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e kandidatëve të cilët aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, janë të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 16.07.2014 “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)” dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 16, datë 01.08.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga Fondi i Ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”, i ndryshuar. Aktet nënligjore të sipërcituar janë publikuar në rubrikën e Fondit të Ekselencës në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Aplikimet do të jenë individuale dhe klasifikimi i kandidatëve do të jetë transparent.

Aplikimet, për kandidatët që ndjekin vitin e parë të studimeve për këtë vit akademik (2019-2020), dërgohen në MASR në një nga periudhat:

1 Mars–30 Prill 2019 (Faza I).

1 Gusht –30 Shtator 2019 (Faza II).

Aplikimet për kandidatët që do të ndjekin vitin e dytë apo pas tij të studimeve, dërgohen në MASR në një nga periudhat:

1 –31 Korrik 2019.

1 Shtator –15 Tetor 2019.

*Aplikime të depozituara në MASR jashtë afateve të sipërcituara nuk do të pranohen apo procedohen.

Dokumentet dërgohen me postë në adresën:

Fondi i Ekselencës
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Rr. Durrësit, nr. 23ALB-1001-TIRANA

Për çdo informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me E-mail në adresën elektronike:
fondi.ekselenca@arsimi.gov.al